

**KONVENTA KUNDËR TORTURËS DHE TRAJTIMEVE A DËNIMEVE TË
TJERA MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE**

**Miratur dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e
Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984**

HYRË NË FUQI: më 26 qershor 1987
në përputhje me nenin 27 (1)

Shtetet palë të kësaj Konvente,

*Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e
Kombeve të Bashkuara, njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë
pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,*

Duke njohur se këto të drejta burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut,

*Duke pasur parasysh se Karta u ngarkon shteteve si detyrë, sidomos neni 55, për
të nxitur respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut,*

*Duke marrë parasysh nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe
nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat që të dyja
përcaktojnë se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as trajtimeve a dënimeve të
tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese,*

*Duke marrë parasysh gjithashtu Deklaratën për Mbrojtjen e të Gjithë Personave
nga Pësimi i Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose
Poshtëruese, të miratur nga Asambleja e Përgjithshme më 9 dhjetor të vitit 1975,*

*Duke dëshiruar që luftën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera
mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ta bëjnë sa më efektive në botë,*

U morën vesh për sa vijon:

PJESA E PARË

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj Konvente termi “torturë” nënkupton çdo veprim me të cilin
personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me

qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.

2. Ky nen nuk cenon asnjë dokument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që përmban ose mund të përmbajë dispozita të një zbatimi më të gjerë.

Neni 2

1. Çdo shtet palë merr masa efektive legjislative, administrative, gjyqësore, ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij.

2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.

3. Urdhëri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.

Neni 3

1. Asnjë shtet palë nuk do të dëbojë, nuk do të prapësojë, e as nuk do të ekstradojë një person në një shtet tjetër ku ka arsye serioze për të besuar sa ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës.

2. Me qëllim të përcaktimit nëse ekzistojnë arsye të tilla, autoritetet kompetente do të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse duke përfshirë, kudo që është e zbatueshme, ekzistimin e një vister dhunimesh sistematike, të rënda, flagrante ose masive të të drejtave të njeriut në një shtet përkatës.

Neni 4

1. Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tentim ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim.

2. Çdo shtet palë do të japë dënime përkatëse për këto vepra penale duke marrë parasysh seriozitetin e tyre.

Neni 5

1. Çdo shtet palë merr masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e përmendura në nenin 4, në raste e mëposhtme:

(a) Kur veprat penale kryhen në cilindo territor nën juridiksionin e vet ose në anije apo aeroplan të regjistruar në atë shtet,

(b) Kur kryerësi i supozuar është shtetas i atij shteti,

(c) Kur viktima është shtetas i atij shteti, në qoftë se ky shtet konsideron se një gjë e tillë është e përshtatshme.

2. Çdo shtet palë merr gjithashtu masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e sipërpërmendura në rastin kur kryerësi i supozuar i tyre ndodhet në cilindo territor nën juridiksionin e tij dhe kur shteti në fjalë nuk e ekstradon në përputhje me nenin 8, në ndonjërin nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë kompetencë penalo-juridike që ushtrohet në përputhje me ligjet e një vendi.

Neni 6

1. Në qoftë se në bazë të shqyrtimit të informacioneve që i ka në dispozicion bindet se rrethanat justifikojnë një gjë të tillë, çdo shtet palë në territorin e të cilit ndodhet personi për të cilin dyshohet se ka kryer një vepër penale të përmendur në nenin 4, siguron paraburgimin e këtij personi ose merr masa të tjera juridike për të siguruar praninë e tij. Ky paraburgim dhe masat e tjera juridike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e këtij shteti, por mund të vazhdohen vetëm gjatë kohës së nevojshme për ndjekje penale ose për një procedurë ekstradimi.

2. Shteti i tillë fillon menjëherë një hetim paraprak për të përcaktuar faktet.

3. Çdo person i paraburgosur, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të ndihmohet për të komunikuar menjëherë me përfaqësuesin e kualifikuar më të afërt të shtetit ku ai është shtetas ose, po qe se është person pa shtetësi, me përfaqësuesin e shtetit ku ai jeton zakonisht.

4. Kur një shtet ka paraburgosur një person, në përputhje me dispozitat e këtij neni, ai njofton menjëherë shtetet e përmendura në nenin 5, paragrafin 1 lidhur me këtë paraburgim dhe me rrethanat që e justifikojnë. Shteti që kryen hetimin paraprak në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, informon menjëherë shtetet në fjalë lidhur me përfundimet dhe u komunikon nëse ka ndërmend të ushtrojë kompetencën e vet.

Neni 7

1. Shteti palë, në territorin e të cilit është gjetur kryerësi i supozuar i një vepre penale të përmendur në nenin 4, në rast se nuk e ekstradon atë, ua parashtron çështjen në rastin e

parashikuar në nenin 5, autoriteteve të veta kompetente me qëllim të marrjes së masave të ndjekjes penale.

2. Këto autoritete marrin vendime në të njëjtat kushte sikurse edhe për çdo veprë penale ordinere të një natyre serioze, sipas të drejtës së këtij shteti. Në rastet e parashikuara në nenin 5, paragrafin 2, standardet e dëshmisë që zbatohen për ndjekjen dhe dënimin nuk janë në asnjë mënyrë më pak të rrepta ose ato që zbatohen në rastet e parashikuara në nenin 5, paragrafin 1.

3. Çdo personi të ndjekur për një nga veprat e parashikuara në nenin 4 i garantohet një trajtim i bazuar në drejtësi në të gjitha fazat e procesit.

Neni 8

1. Veprat e parashikuara në nenin 4 duhet të përfshihen detyrimisht në çdo traktat ekstradimi të përfunduar ndërmjet shteteve palë. Shtetet palë zotohen t'i përfshijnë veprat e sipërpërmendura në çdo traktat ekstradimi që do të përfundohet ndërmjet tyre.

2. Në qoftë se një shtet palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati, merr një kërkesë ekstradimi nga një tjetër shtet palë me të cilin nuk është i lidhur me një traktat ekstradimi, ai mund ta konsiderojë këtë konventë një bazë juridike për ekstradim përse u përket veprave penale të sipërpërmendura. Ekstradimi varet nga kushtet e tjera të parashikuara nga e drejta e shtetit të cilit i është paraqitur kërkesa.

3. Shtetet palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati i njohin veprat e sipërpërmendura si rast ekstradimi ndërmjet tyre në kushtet e parashikuara nga e drejta e shtetit të cilit i është paraqitur kërkesa.

4. Ndërmjet shteteve palë veprat e sipërpërmendura konsiderohen, përse i përket mundësisë së ekstradimit, të kryera si në vendin ku kanë ndodhur ashtu edhe në territorin që është nën juridiksionin e shteteve të cilat detyrohen të vendosin kompetencën e tyre në bazë të nenit 5, paragrafit 1.

Neni 9

1. Shtetet palë i japin njëri tjetrit ndihmë juridike sa më të gjerë në çdo proces penal në lidhje me veprat e përmendura në nenin 4, duke përfshirë njoftimin e të gjitha elementeve provuese që ato kanë në dispozicion dhe që janë të nevojshme për qëllimet e procesit.

2. Shtetet palë i kryejnë detyrimet e tyre në bazë të paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me çdo traktat ndihme të ndërsjellë juridike që mund të ekzistojë ndërmjet tyre.

Neni 10

1. Çdo shtet palë siguron që arsimi dhe informacioni në lidhje me ndalimin e torturës të jenë pjesë përbërëse e trajnimit të personelit civil ose ushtarak të ngarkuar për zbatimin e ligjeve, të personelit mjekësor, të personave zyrtarë dhe të personave të tjerë të cilët

mund të marrin pjesë në ruajtjen, marrjen në pyetje ose trajtimin e çdo individi të paraburgosur, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre.

2. Çdo shtet palë përfshin ndalimin e sipërpërmendur në rregullat ose udhëzimet e nxjerra lidhur me detyrimet dhe atributet e personave të tillë.

Neni 11

Çdo shtet palë ushtron një mbikëqyrje sistematike të rregullave, udhëzimeve, metodave dhe praktikave të pyetjes dhe të dispozitave lidhur me ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij, me qëllim që të mënjanohet çdo rast i torturës.

Neni 12

Çdo shtet palë siguron që autoritetet kompetente të fillojnë menjëherë një hetim të paanshëm kurdoherë që ka motive të arsyeshme për të besuar se një veprim i torturës është kryer në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij.

Neni 13

Çdo shtet palë i siguron çdo personi që pretendon se i është nënshtruar torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij të drejtën e ankimit pranë autoriteteve kompetente të shtetit në fjalë, të cilat do ta shqyrtojnë çështjen menjëherë dhe me paanësi. Do të merren masa për të siguruar mbrojtjen e ankuesit dhe të dëshmitarëve kundër keqtrajtimit ose frikësimit si pasojë e ankimit ose e dhënies së një dëshmie.

Neni 14

1. Çdo shtet palë, në sistemin e vet juridik, i siguron viktimës së një akti të torturës të drejtën për të kërkuar reparacion dhe për t'u dëmshpërblyer me drejtësi dhe në mënyrë adekuate, duke përfshirë mjetet e nevojshme për riaftësim sa më të shpejtë. Në rast të vdekjes së viktimës si pasojë e një veprimi të torturës, ata që kanë pasur pasoja prej saj kanë të drejtë për dëmshpërblim.

2. Ky nen nuk përjashton asnjë të drejtë për dëmshpërblimin të cilin viktimat ose personat e tjerë do t'i gëzonin në bazë të ligjeve të vendit.

Neni 15

Çdo shtet palë siguron për çdo deklaratë e cila është provuar të jetë marrë nëpërmjet torturës, të mos përdoret si element prove në një proces, përveç rastit kur ky fakt përdoret kundër personit të akuzuar për torturë për të provuar se është dhënë deklarata.

Neni 16

1. Çdo shtet palë zotohet të parandalojë në çdo territor nën juridiksionin e tij veprime të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, që nuk janë veprime torture, siç është përcaktuar kjo në nenin 1, kur veprime të tilla janë kryer nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me titull zyrtar, ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur. Në veçanti, detyrimet e përfshira në nenet 10, 11, 12 dhe 13, janë të zbatueshme duke përmendur në vend të torturës forma të tjera të dënimeve a trajtimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Dispozitat e kësaj Konvente nuk pengojnë dispozitat e cilitdo instrument tjetër ndërkombëtar ose të ligjit të vendit, që ndalojnë dënimet a trajtimet mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, ose kanë të bëjnë me ekstradimin a dëbimin.

PJESA E DYTË

Neni 17

1. Krijohet një Komitet Kundër Torturës (në tekstin e mëtejshëm: “Komiteti”), i cili ushtron funksionet e përcaktuara në tekstin në vazhdim. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe me një kompetencë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët marrin pjesë në cilësi vetjake. Ekspertët zgjedhen nga shtetet palë duke pasur parasysh një ndarje gjeografike të drejtë dhe interesin e pjesëmarrjes në punimet e Komitetit të personave që kanë një përvojë juridike.

2. Anëtarët e Komitetit zgjedhen me votim të fshehtë nga një listë kandidatësh të caktuar nga shtetet palë. Çdo shtet palë mund të caktojë një kandidat të zgjedhur nga radhët e shtetasve të tij. Shtetet palë duhet të kenë parasysh interesin që ekziston për të caktuar kandidatët që janë njëkohësisht anëtarë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të krijuar në bazë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe që të kenë vullnet të mirë për të marrë pjesë në Komitetin Kundër Torturës.

3. Anëtarët e Komitetit zgjedhen në mbledhjet dyvjeçare të shteteve palë që i thërret Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, ku kuorumi përbëhet nga dy të tretat e shteteve palë, anëtarë të Komitetit zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë që janë të pranishme dhe që marrin pjesë në votim.

4. Zgjedhja e parë duhet të bëhet jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes së kësaj Konvente në fuqi. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, u dërgon një letër shteteve palë

duke i ftuar që të paraqesin kandidaturat e tyre brenda tre muajve. Sekretari i Përgjithshëm harton një listë me rend alfabetik të të gjithë kandidatëve të propozuar në këtë mënyrë, duke treguar shtetet palë që i kanë caktuar dhe ua dërgon shteteve palë.

5. Anëtarët e Komitetit zgjedhen për një mandat prej katër vitesh. Ata mund të rizgjedhen po të paraqiten sërish. Megjithatë, mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë merr fund pas dy viteve. Kryesuesi i mbledhjes së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni i cakton me short emrat e këtyre pesë anëtarëve mënjëherë pas zgjedhjes së parë.

6. Në qoftë se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqje nga funksioni i tij, apo për çfarëdo arsye tjetër nuk është më në gjendje t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në Komitet, shteti palë që e ka caktuar emëron nga radhët e shtetasve të vet një ekspert tjetër i cili merr pjesë në Komitet për pjesën e mbetur të mandatit, por që këtë ta miratojë shumica e shteteve palë. Ky miratim quhet i siguruar përveç rastit kur gjysma e shteteve palë, ose më tepër, shfaqin një mendim të pafavorshëm brenda gjashtë javësh duke filluar nga çasti kur janë njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për emërimin e propozuar.

7. Shtetet palë i heqin shpenzimet e anëtarëve të Komitetit për periudhën gjatë së cilës ata ushtrojnë funksionet e veta në Komitet.

Neni 18

1. Komiteti zgjedh byronë e vet për një periudhë dyvjeçare. Kjo byro mund të rizgjedhet.

2. Komiteti harton vetë rregulloren e tij të brendshme; kjo rregullore duhet, *ndër të tjera*, të përmbajë këto dispozita:

- (a) Kuorumi përbëhet nga gjashtë anëtarë;
- (b) Vendimet e Komitetit merren me shumicën anëtarëve të pranishëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara siguron për Komitetin personelin dhe pajisjet materiale që i nevojiten për të ushtruar në mënyrë efektive funksionet që i janë besuar në bazë të kësaj Konvente.⁹

4. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara thërret anëtarët e Komitetit për mbledhjen e parë. Pas mbledhjes së parë Komiteti mblidhet kurdoherë që përcaktohet me rregulloren e tij të brendshme.

5. Shtetet palë marrin përsipër heqjen e shpenzimeve që bëhen për mbledhjet e shteteve palë dhe të Komitetit, duke përfshirë kompensimin në dobi të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të gjitha shpenzimet, siç janë pagat e personelit dhe kostoja e

pajisjeve materiale, që Organizata e Kombeve të Bashkuara do t'i vërë në dispozicion në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 19

1. Shtetet palë i paraqesin Komitetit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raportet lidhur me masat që kanë marrë për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj Konvente, brenda një viti pas hyrjes së kësaj Konvente në fuqi për çdo shtet palë të interesuar. Përveç kësaj, shtetet palë paraqesin raporte plotësuese, çdo katër vite, për të gjitha masat e reja që kanë marrë, dhe raporte të tjera të cilat mund t'i kërkojë Komiteti.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ua dërgon raportet të gjitha shteteve palë.

3. Komiteti shqyrton çdo raport dhe mund të japë vërejtje të atilla të përgjithshme të cilat i quan të duhura dhe ia dërgon këto vërejtje shtetit palë përkatës. Çdo shtet palë mund t'ia dërgojë Komitetit, si përgjigje, të gjitha vërejtjet që i konsideron të nevojshme.

4. Komiteti, sipas dëshirës së tij, mund të vendos që në raportin vjetor të cilin ai harton në përputhje me nenin 24 të përfshijë të gjitha vërejtjet që i ka bërë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, së bashku me vërejtjet që ka marrë për këtë çështje nga shteti palë i interesuar. Në qoftë se shteti palë i interesuar kërkon, Komiteti gjithashtu mund të përfshijë raportin e paraqitur sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 20

1. Në qoftë se Komiteti merr informacione të besueshme, në bazë të të cilave, sipas mendimit të tij, ekzistojnë tregues të bazuar se tortura praktikohet sistematikisht në territorin e ndonjë shteti palë, atëherë Komiteti fton shtetin në fjalë që të bashkëpunojë në shqyrtimin e këtyre informacioneve dhe të bëjë vërejtjet e tij për këtë çështje.

2. Duke marrë parasysh të gjitha vërejtjet e paraqitura eventualisht nga shteti palë i interesuar dhe çdo njoftim tjetër përkatës që ai disponon, Komiteti mundet, nëse e konsideron të arsyeshme, të caktojë një ose disa anëtarë të tij për të bërë një hetim konfidencial dhe t'i paraqesin një raport me ngutësi.

3. Në qoftë se zhvillohet një hetim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti kërkon bashkëpunimin e këtij shteti palë të interesuar. Në marrëveshje me këtë shtet palë, një hetim i tillë mund të përfshijë edhe vizitën e territorit të këtij shteti.

4. Pasi t'i ketë shqyrtuar konkluzionet e anëtarit ose të anëtarëve të cilët i janë paraqitur në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti ia dërgon këto konkluzione

shtetit palë të interesuar, me të gjitha komentet dhe sugjerimet të cilat i konsideron të përshtatshme duke pasur parasysh gjendjen.

5. Të gjitha procedurat e Komitetit që përmenden në paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, janë konfidenciale dhe, në të gjitha fazat e procedurave, bëhen përpjekje për të siguruar bashkëpunimin e shtetit palë. Pasi kanë përfunduar procedurat lidhur me hetimin e zhvilluar në përputhje me paragrafin 2, Komiteti mundet, pas konsultimeve me shtetin palë të interesuar, të vendosë që një parashtesë e përmbledhur e rezultateve të punimeve të figurojë në raportin vjetor që ai harton në përputhje me nenin 24.

Neni 21

1. Çdo shtet palë i kësaj Konvente, sipas këtij neni, mund të deklarojë kurdoherë se njih kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar njoftime me anën e të cilave një shtet palë pohon se një shtet tjetër palë nuk përmbush detyrimet e tij në bazë të kësaj Konvente. Këto njoftime mund të merren dhe shqyrtohen në përputhje me procedurën që përmendet në këtë nen vetëm në qoftë se i ka paraqitur shteti palë që ka bërë një deklaratë nëpërmjet të cilës ai njih kompetencën e Komitetit. Komiteti nuk pranon asnjë njoftim që ka të bëjë me një shtet palë i cili nuk ka bërë një deklaratë të tillë. Njoftimet që janë marrë në përputhje me këtë nen do të kenë të bëjnë me procedurën e mëposhtme:

(a) Në qoftë se një shtet palë konsideron se një shtet tjetër palë nuk i zbaton dispozitat e kësaj Konvente, ai mund t'ia tërheq vëmendjen këtij shteti, me një njoftim me shkrim, lidhur me këtë çështje. Brenda tre muajve nga data e marrjes së njoftimit shteti të cilit i është dërguar njoftimi do t'ia dërgojë shtetit nga i cili ka marrë njoftimin shpjegime ose çdo deklaratë tjetër me shkrim për sqarimin e çështjes, të cilat përfshijnë për aq sa është e mundur dhe e dobishme, të dhëna për rregullat e procedurës dhe për mjetet juridike qoftë të përdorura më parë, qoftë në vazhdim, qoftë ende të hapura.

(b) Në qoftë se brenda gjashtë muajve, pas marrjes së njoftimit të parë nga shteti të cilit i është dërguar, çështja nuk është rregulluar asisoj që të kënaqë të dyja shtetet palë të interesuara, si njëri ashtu edhe tjetri do të kenë të drejtë për t'ia shtruar Komitetit, duke i dërguar një notë si Komitetit ashtu edhe shtetit tjetër të interesuar.

(c) Komiteti mund të shqyrtojë një çështje, sipas këtij neni, vetëm pasi të jetë siguruar se janë përdorur dhe shtruar të gjitha mjetet juridike të brendshme të mundshme, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, të njohura përgjithësisht. Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur procedurat sipas mjeteve juridike i kalojnë afatet e arsyeshme, dhe as në rastet kur gjasat janë të vogla që këto procedura të kënaqin personin i cili është viktimë e shkeljes së kësaj Konvente;

(ç) Komiteti mban mbledhje me dyer të mbyllura kur shqyrton informacionet e parapara me këtë nen;

(d) Në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (c), Komiteti u vë në dispozicion shërbimet e tij të mira shteteve palë të interesuara, me qëllim që të arrihet një zgjidhje pajtimi të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të parapara me këtë Konventë. Për këtë qëllim, Komiteti, po qe se mendon se është e dëshirueshme, mund të kërkojë formimin e një komisioni *ad hoc* të pajtimit;

(dh) Në çdo çështje që i është parashtruar, sipas këtij neni, Komiteti mund t'u kërkojë shteteve palë të interesuara, që përmenden në nënparagrafin (b), që t'i japin çdo informacion përkatës lidhur me këtë çështje.

(e) Shtetet palë të interesuara, që përmenden në nënparagrafin (b), kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komiteti si dhe t'i paraqesin vërejtjet e tyre me shkrim ose me gojë, në një formë a në një tjetër.

(ë) Komiteti paraqet një raport brenda dymbëdhjetë muajve pas datës kur ka marrë njoftimin siç përmendet në nënparagrafin (b):

(i) Në qoftë se është arritur një zgjidhje në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (d), Komiteti kufizon raportin e vet me një paraqitje të shkurtër të fakteve dhe të zgjidhjes së arritur;

(ii) Në qoftë se nuk është arritur ndonjë zgjidhje në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (d), Komiteti e kufizon raportin e vet me një paraqitje të shkurtër të fakteve: teksti dhe procesverbali i vërejtjeve të paraqitura gojarisht nga shtetet palë të interesuara i bashkëngjiten raportit. Për çdo çështje, raporti u komunikohet shteteve palë të interesuara.

2. Dispozitat e këtij neni hyjnë në fuqi atëherë kur pesë shtete palë të kësaj Konvente japin deklaratat sipas paragrafit 1 të këtij neni. Këto deklarata i depozitojnë shtetet palë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili u dërgon nga një kopje shteteve të tjera palë. Një deklaratë mund të tërhiqet kurdoherë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk paragjykon shqyrtimin e ndonjë çështjeje që është objekt i një njoftimi të dërguar më parë sipas këtij neni; asnjë njoftim tjetër i një shteti palë nuk do të pranohet, sipas këtij neni, pasi Sekretari i Përgjithshëm të ketë marrë njoftimin për tërheqjen e deklaratës, me përjashtim të rastit kur shteti palë i interesuar të ketë dhënë një deklaratë të re.

Neni 22

1. Një shtet palë i kësaj Konvente, sipas këtij neni, mund të deklarojë kurdoherë se njeh kompetencën e Komitetit për të pranuar dhe shqyrtuar njoftimet që i paraqesin individët ose në emër të individëve që bëjnë pjesë në juridiksionin e tij, të cilët pohojnë se janë viktimë të shkeljes së dispozitave të kësaj Konvente nga ana e një shteti palë. Komiteti nuk pranon asnjë njoftim që ka të bëjë me një shtet palë i cili nuk ka dhënë një deklaratë të tillë.

2. Komiteti konsideron të papranueshëm çdo njoftim të paraqitur sipas këtij neni, në qoftë se njoftimi është anonim ose që ai e konsideron si një shpërdorim të së drejtës për paraqitjen e njoftimeve të tilla, ose në qoftë se nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Me rezervën e dispozitave të paragrafit 2, Komiteti ia komunikon shtetit palë të kësaj Konvente çdo njoftim që i është paraqitur në bazë të këtij neni i cili ka bërë një deklaratë në bazë të paragrafit 1 dhe që supozohet se ka shkelur një nga dispozitat e Konventës. Brenda gjashtë muajve në vazhdim, shteti në fjalë i paraqet me shkrim Komitetit shpjegime ose deklarata të cilat do të ndriçojnë çështjen dhe që tregojnë, kur është rasti, masat që mund të jenë marrë për ta rregulluar gjendjen.

4. Komiteti shqyrton njoftimet e marra në përputhje me këtë nen duke pasur parasysh të gjitha informacionet që i janë paraqitur nga ose për llogari të individit dhe të shtetit palë të interesuar.

5. Komiteti nuk do të shqyrtojë asnjë njoftim që ka paraqitur ndonjë individ, sipas këtij neni, pa u siguruar se:

(a) E njëjta çështje nuk është shqyrtuar dhe nuk është duke u shqyrtuar përpara ndonjë instance tjetër ndërkombëtare hetimore ose vendimore;

(b) Individit ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike të mundshme; kjo nuk duhet të jetë rregull në qoftë se zbatimi i mjeteve juridike i kalon afatet e arsyeshme ose në qoftë se ka pak të ngjarë që ato t'i jepnin satisfaksion individit i cili është viktimë e shkeljes së kësaj Konvente.

6. Komiteti mban mbledhje me dyer të mbyllura kur shqyrton njoftimet e paraqitura sipas këtij neni.

7. Komiteti ia përcjell konstatimet e veta shtetit palë të interesuar dhe individit;

8. Dispozitat e këtij neni do të hyjnë në fuqi atëherë kur pesë shtete palë të kësaj Konvente të kenë dhënë deklarata sipas paragrafit 1 të këtij neni. Shtetet palë i depozitojnë deklaratat e tilla pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara i cili u dërgon kopjet e tyre shteteve të tjera palë. Një deklaratë mund të tërhiqet kurdoherë nëpërmjet një njoftimi të dërguar më parë Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk pengon shqyrtimin e çdo çështjeje e cila është objekt i një njoftimi i dërguar më parë në përputhje me këtë nen; asnjë njoftim tjetër i paraqitur nga ose për llogari të një individi nuk do të pranohet, në përputhje me këtë nen, pasi Sekretari i Përgjithshëm të ketë pranuar njoftimin lidhur me tërheqjen e deklaratës, me përjashtim të rastit kur shteti palë i interesuar të ketë dhënë një deklaratë të re.

Neni 23

Anëtarët e Komitetit dhe anëtarët e komisioneve *ad hoc* të pajtimit, që mund të emërohen në përputhje me nenin 21, paragrafi 1 (d), kanë të drejtë të gëzojnë lehtësitë, privilegjet dhe imunitetet që u njihen ekspertëve të cilët i ngarkon me mision Organizata e Kombeve të Bashkuara, ashtu siç janë përcaktuar në sesionet përkatëse të Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 24

Komiteti u paraqet çdo vit shteteve palë dhe Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara një raport për veprimtarinë që ai ka ndërmarrë në përputhje me këtë Konventë.

PJESA E TRETË

Neni 25

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e të gjitha shteteve.
2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 26

Kjo Konventë është e hapur për aderimin e çdo shteti. Aderimi do të bëhet duke depozituar instrumentin e aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 27

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e tridhjetë nga data e depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që do të ratifikojë këtë Konventë ose që do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose të aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë nga data e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 28

1. Çdo shtet, në çastin kur do të nënshkruajë ose do të ratifikojë këtë Konventë, mund të deklarojë se nuk njeh kompetencat që i janë dhënë Komitetit sipas nenit 20.

2. Çdo shtet palë i cili ka bërë vërejtjen, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kurdoherë mund ta tërheqë këtë vërejtje duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 29

1. Çdo shtet palë i kësaj Konvente mund të propozojë ndonjë amendament dhe ta depozitojë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua kumtojë amendamentin e propozuar shteteve palë me kërkesën që të njoftojnë nëse janë në favor të thirrjes së një konference të shteteve palë për ta shqyrtuar propozimin dhe për të votuar për të. Në qoftë se brenda katër muajve nga data e komunikimit të tillë, të paktën një e treta e shteteve palë deklarohen në favor të thirrjes së konferencës, Sekretari i Përgjithshëm do ta thërrasë konferencën nën patronazhin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e shteteve palë të pranishme dhe votuese në konferencë do t'u paraqitet për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha shteteve palë.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të hyjë në fuqi atëherë kur dy të tretat e shteteve palë të kësaj Konvente do ta kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara se ato kanë pranuar atë në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.

3. Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato bëhen të detyrueshme për shtetet palë që i kanë pranuar, ndërsa shtetet e tjera palë mbeten akoma të lidhura me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjitha amendamentet e mëparshme që janë pranuar prej tyre.

Neni 30

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente e cila nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve i shtrohet një arbitrazhi me kërkesën e njërit prej këtyre shteteve. Në qoftë se brenda gjashtë muajve nga data kur është bërë paraqitja e kërkesës për arbitrazh këto palë nuk arrijnë të merren vesh rreth organizimit të arbitrazhit, cilado prej këtyre palëve mund të paraqesë kundërshtim pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë duke paraqitur këtë kërkesë në përputhje me Statutin e kësaj gjykate.

2. Çdo shtet, në çastin e nënshkrimit ose të ratifikimit të kësaj Konvente, ose të aderimit në të, mund të deklarojë se nuk konsideron veten të jetë i lidhur me paragrafin 1 të këtij neni. Shtetet e tjera palë nuk do të jenë të lidhura me këtë paragraf ndaj çdo shteti palë i cili do të ketë formuluar një rezervë të tillë.

3. Çdo shtet palë që do të ketë formuluar një rezervë në përputhje me nenin 2 të këtij neni, mund ta tërheqë këtë rezervë kurdoherë nëpërmjet një njoftimi që ia dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 31

1. Një shtet palë mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pasi Sekretari i Përgjithshëm të ketë marrë njoftimin.

2. Një denoncim i tillë nuk do ta lirojë shtetin palë nga detyrimet që ka në përputhje me këtë Konventë përsa i përket çdo veprimi ose mosveprimi të kryer para datës së hyrjes së denoncimit në fuqi; ai po ashtu nuk do të pengojë aspak vazhdimin e shqyrtimit të çdo çështjeje të cilën Komiteti e ka shqyrtuar para hyrjes së denoncimit në fuqi.

3. Pas datës së hyrjes së denoncimit në fuqi të një shteti palë, Komiteti nuk ndërmerr shqyrtimin e asnjë çështjeje të re lidhur me këtë shtet.

Neni 32

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha shtetet që do të kenë nënshkruar këtë Konventë ose do të kenë aderuar në të:

(a) Lidhur me nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet e marra në përputhje me nenet 25 dhe 26;

(b) Lidhur me datën e hyrjes së kësaj Konvente në fuqi në përputhje me nenin 27 dhe me datën e hyrjes së çdo amendamenti në fuqi në përputhje me nenin 29;

(c) Lidhur me denoncimet e marra në përputhje me nenin 31.

Neni 33

1. Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'u dorëzojë të gjitha shteteve nga një kopje të vërtetuar të kësaj Konvente.